



Pranuar / Dorezuar Prilbena / Predato Received / Delivered	26.06.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Org. / Jednica Org. / Unit	SKANSKO	4914/2023	Sasia Kolicina Quantity
			1/4



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.803/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.803/2023 të datës 02.06.2022 të parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_ kundër shqiptimit të masës disiplinore "Vërejtje" përmes aktit me Nr. 01-11/2023 të datës 02.05.2023 të shqiptuar nga Drejtori i Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Rahovecit, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 26.06.2023, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.803/2023 e datës 02.06.2023 e parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_
- II. **Anulohet** akti me Nr. 01-11/2023 i datës 02.05.2023 i Drejtorit të Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Rahovecit lidhur masës disiplinore "Vërejtje" të shqiptuar ndaj ankueses \_\_\_\_\_.
- III. **Obligohet** Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Rahovecit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë zbatimin e këtij vendimi duke bërë shuarjen e masës disiplinore ndaj ankueses në pajtim me këtë vendim.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



## A r s y e t i m

Ndaj ankueses, e punësuar sipas Akt Emërimit AE.Nr.397/2021 të datës 28.04.2021 në pozitën "Zyrtare për Shërbime Sociale", në Komunën e Rahovecit, Drejtori i Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Rahovecit përmes aktit me Nr. 01-11/2023 të datës 02.05.2023 i ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje".

Ankuesja kundër masës disiplinore, përmes emailit [ankesa.kmpshck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kmpshck@rks-gov.net), më datë 01.06.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila më datë është regjistruar më datë 02.06.2023 nën shenjën A.nr.803/2023 me numër protokolli 4572/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.06.2023 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankueses nga Komuna e Rahovecit. Ndërsa Këshilli më datë 20.06.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ,me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 4572/2023 e datës 02.06.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 01/9/2020 i datës 26.04.2023; Aktin me Nr. 01-11/2023 të datës 02.05.2023 të Drejtorit të Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Rahovecit për shqiptimin e masës disiplinore; Ankesën e datës 25.04.2023 nga M.M; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 12.06.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 20.06.2023; Akt Emërimit AE.Nr.397/2021 i datës 28.04.2023; Vendimin me Nr. 2125 i datës 18.05.2022; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar për Shërbime Sociale i datës 25.09.2012; Njoftimin e datës 25.04.2023 përmes emailit nga ankuesja për G.M; Shkresë/dorëheqje e datës 25.04.2023 nga ankuesja për Y.R; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesen i datës 29.01.2021, 31.01.2023; Dosjen me Nr. 16-6978; Shkresë për paraqitje të rastit me Nr. 02-570/21 e datës 23.11.2021; Plani i Shërbimeve i Qendrës Për Punë Sociale i datës 23.11.2021; Ftesë për përcjelle të kontaktit dhe puna me rast datë 23.11.2021, 25.11.2021, 11.02.2022, 10.02.2022, 11.02.2022, 14.02.2022, 04.03.2022, 18.03.2022, 01.04.2022, 06.07.2022, 31.01.2023; Procesverbal mbi marrjen në pyetje palën i datës 25.11.2021, 10.02.2022; Kupton Fiskal nga ; Aktgjykim C.nr.1133/2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka Konstatuar se ankesa e ankueses, është e bazuar, sepse:

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër aktit me Nr. 01-11/2023 të datës 02.05.2023 të Drejtorit të Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Rahovecit lidhur shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje", pretendon që





Drejtori i Qendrës për Punë Sociale nuk është mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, si rrjedhojë kjo masë është shqiptuar si rezultat i shkeljeve procedurale dhe materiale.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji Këshillit ka analizuar provat materiale po ashtu edhe përgjigjen në ankesë të datës 20.06.2023 të dërguar nga Komuna e Rahovecit, dhe mbi bazën e administrimit të tyre rrjedh se sipas Vendimit me Nr.2125 të datës 18.05.2022 të Kryetarit të Komunës së Rahovecit nëpunësja znj. G.M është autorizuar për ushtrimin e pozitës së Udhëheqësit të Sektorit për Shërbime Sociale në Qendrën për Punë Sociale në Komunën e Rahovecit, po ashtu në bazë të përgjigjes në ankesë të datës 20.06.2023 të dërguar nga Komuna e Rahovecit potencohet se ankuesja H.T i raporton respektivisht ka mbikëqyrës të drejtpërdrejtë Udhëheqësin e Sektorit për Shërbime Sociale në Qendrën për Punë Sociale, ndërsa Drejtori i Qendrës për Punë Sociale nuk është mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i ankueses.

Bazuar në këtë Kolegji i Këshillit, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht kapitullin IV, lidhur me Disiplinën në Shërbim Civilë, si dhe Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, me të cilën është rregulluar në mënyrë specifike procedura dhe masat disiplinore për nëpunësit civil. Ndërsa në kuptim të kompetencës për iniciimin e procedurës disiplinore dhe shqiptimin e masave disiplinore, Kolegji ju referua nenit 47 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin shprehimisht është përcaktuar se: *1.Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil, ndërlidhur me këtë neni 48 paragrafi 1 i po këtij ligji ka përcaktuar se: 1.Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë”,* rrjedhimisht sipas provave të lëndës dhe referuar bazës ligjore të potencuar si më lart, Kolegji i Këshillit, konstaton se Drejtori i Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Rahovecit meqenëse nuk është mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i ankueses nuk ka pasur kompetencë për të shqiptuar ndaj ankueses masën disiplinore “Vërejtje”, kështu që pretendimi i ankueses se lidhur me shqiptimin e masës disiplinore janë shkelur dispozitat procedurale është i bazuar.

Kolegji i Këshillit, nga konstatimet si më lartë, thekson faktin se akti me Nr. 01-11/2023 i datës 02.05.2023 i Drejtorit të Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Rahovecit lidhur masës disiplinore “Vërejtje” të shqiptuar ndaj ankueses, është i paligjshëm në kuptim të dispozitave nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 ndërlidhur me nenin 4 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nuk u lëshua në konstatimet e ligjshmërisë materiale të pretendimeve ankimore të ngritura në ankesë.

Si u tha më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Rahovecit është i obliguar që në pajtim me dispozitivin e këtij vendimi të bëjnë shuarjen e masës disiplinore ndaj ankueses.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nën 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.803/2023, datë 26/06/2023

**Avdyl BEKTESHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Arben MEHMETI**

Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet**

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Rahovecit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Rahovecit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

